



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3100/ 6 prot.

Datë 03/12/2025

V E N D I M

Nr. 1770/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03/12/2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AGRO-KORANI” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me numër reference Nr. REF-61956-09-18-2025, me objekt: “Blerje Plehra Kimik, Furnitura Veterinare, Farëra, Fidanë e të tjera produkte Agrokulturore”, e ndarë në lote”, me fond limit të përgjithshëm 7,409,362 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AlbGarden” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me numër reference Nr. REF-61956-09-18-2025, me objekt: “Blerje Plehra Kimik, Furnitura Veterinare, Farëra, Fidanë e të tjera produkte Agrokulturore”, me fond limit të përgjithshëm 7,409,362 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK me NIPT: K83725201G dhe me adresë: Mazhe e Madhe, Nr pasurie 57/3, zk 2621, Vol.5 Fq 216, Krujë, Durrës.

- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit
Adresa: Rruga "5 Maji", Tiranë.
- Persona të interesuar:** Operatori ekonomik "AGRO - KORAN" SHPK me NIPT: L13329801V dhe me adresë: Kavajë, Helmës Tiranë, Helmës, SHTODHER, Ndërtesë 1 katëshe, pranë Urës së DRAXHIT.
- Operatori ekonomik "AlbGarden" SHPK me NIPT: K37513520N dhe me adresë: Lezhë, Lagjja "Skenderbeg", godinë private 1 katëshe në superstradën Lezhë - Shkodër, km 1
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimes ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.09.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me numër reference Nr. REF-61956-09-18-2025, me objekt: “Blerje Plehra Kimik, Furnitura Veterinare, Farëra, Fidanë e të tjera produkte Agrokulturore”, me fond limit të përgjithshëm 7,409,362 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.

II.2. Në datë 06.10.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) rezulton se në datën 22.10.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1	"A.M.E 2020" shpk	me vlerë oferte	4.950.750	leke	skualifikuar
2	"AGRO-KORANI" shpk	me vlerë oferte	5.097.000	leke	skualifikuar
3	"AlbGarden" shpk	me vlerë oferte	5.178.120	leke	skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 22.10.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me arsyet e skualifikimit, përkatësisht si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik ofertues "A.M.E 2020" shpk:

“Operatori ekonomik skualifikohet pasi oferta e paraqitur prej tij konstatohet si anomalisht e ulët. Ndaj në përputhje me nenin 93 pika 5 e Ligjit nr. 162/2020 ‘Për Prokurimin Publik’, të ndryshuar ku përcaktohet “Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”.”.

Operatori ekonomik ofertues " AGRO-KORANI " shpk:

“1. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3. ku përcaktohet “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi:

- Çertifikate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certifikate origjinë të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese

(dekorative) ose Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Certifikate zyrtare model 3 te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe leshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4 te aneksit 4 dhe certifikate origjine të leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative) ...” duke qene se dokumentet “Çertifikatë zyrtare” nr. i serisë 010, leshuar më 18.08.2025 dhe “Çertifikate origjine” leshuar më 18.08.2025, të leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave, të paraqitura nga operatori ekonomik nuk përmbajne mallrat objekt prokurimi (Tulipan (bulbë), Ciklaminë (Cyclamen), Violë, Agapanthus, Nandina domestica)

2. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.2 ku përcaktohet “Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për realizimin e kontratës/ava që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër , me një numër prej mesatarisht 13 (trembëdhjetë), punonjës të punësuar për periudhën 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, përfshirë dhe stafin e mëposhtem.... 2 (dy) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për ”Punime në fidanishte” duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm: • Kontratë pune (e vlefshme).

- Librezë pune

- Diplomë/certifikate sipas ligjit Nr. 15/2017.

Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin e kërkuar në pikën 2.3.2 që disponon sipas formatit të mëposhtem: Tabela 1 Emer Mbiemer i Punonjësit Nr Identifikimi (ID/Letërnjoftim) Profesionit Institucionit Publik/Privat Lëshues i Certifikatës/Diplomës Nr NIPT i Institucionit (nëse privat) operatori ekonomik ofertues me dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, konkretisht ka deklaruar numrin e punonjësve që disponon, si dhe profilet e parashikuara në pikën 2.3.2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, të dokumenteve të tenderit, gjithashtu ka dorëzuar edhe një deklaratë për stafin e angazhuar, pra listë të punonjësve me profesionet përkatëse me të dhënat edhe të kompanisë certifikuese e cila ka leshuar dokumentat certifikata për punonjësit. Në dokumentin “TABELA_1 - Deklarate_per_Satfin_e_Angazhuar”, operatori ekonomik, ka deklaruar që stafi është i certifikuar nga subjekti privat me emrin tregtar “AQS CERT” Shpk me Nipt L31511026K, i cili nuk është i licensuar për ofrimin e kurseve të formimit profesional për (Punime fidanishte) dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, që të jenë të leshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. KVO pasi verifikoi në faqen zyrtare të qkb.gov.al në seksionin kërko në Rregjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në hapsirën Licencat, Lejet e leshuara nga QKB, rezulton se subjekti AQS CERT me nipt L31511026K, nuk është i licensuar nga Ministria e Financave për të ushtruar aktivitetin për formim profesional dhe pajisjen e me certifikata trajnimi punonjës për profilet (Punime në fidanishte). Për sa më lart rezulton se punonjësit e deklaruar si të certifikuar nga subjekti “AQS CERT”, nuk janë të vlefshme dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasi subjekti “AQS CERT” nuk ofron kurse të formimit profesional ndaj oferta e operatori ekonomik nuk konsiderohet e vlefshme.”.

Operatori ekonomik ofertues "AlbGarden" shpk:

“Operatori ekonomik është skualifikuar pasi oferta e paraqitur prej tij rezulton anomalisht e ulët Ndaj në përputhje me nenin 93 pika 5 e Ligjit nr. 162/2020 ‘Për Prokurimin Publik’, të ndryshuar ku percaktohet “Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 24.10.2025 autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e mwsipwrme tw prokurimit.

II.6. Në datën 31.10.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6028 datë 31.10.2025 dhe me numër protokoli nr. 3100/2025 prot, datë 31.10.2025 e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” ShPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës sw paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ofertues “AGRO-KORANI” SHPK, si dhe mbi skualifikimin e ofertës sw paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ofertues “AlbGarden” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3100/1, datë 03.11.2025 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” ShPK, mbi skualifikimin e ofertës sw paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ofertues “AGRO-KORANI” SHPK, si dhe mbi skualifikimin e ofertës sw paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ofertues “AlbGarden” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Në datë 10.11.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 1827/21 prot, datë 07.11.2025 “Vendim”, protokolluar me tonën me nr. 3100/2 prot, datë 10.11.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur mos pranimin e saj, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik se “oferta e AME 2020 është skualifikuar si ofertë anomalisht e ulët. Anomalisht e ulët mbi çfarë baze është bazuar KVO për ofertën anomalisht të ulët si arsye skualifikimi? Me metodën e 25% zbrilje nga fondi limit apo me metodën e 85% të mesatares së ofertave të vlefshme? KVO qëllimisht është e qartë në skualifikimin e ofertës tanë duke thënë arsyen e vetme “ofertë anomalisht e ulët”. Po dy shoqëritë e tjera me çfarë arsye skualifikimi janë skualifikuar? Duke patur parasysh llojin e objektit të prokurimit Që është “blerje malli”, duke patur parasysh kriteret e kualifikimit të

përcaktuara në DST ku vërehet qartazi se përvec sigurimit të ofertës, xhiros, punëve të ngjashme, ISO, pjesa tjetër e kriterëve specifikisht teknike kërkohet të plotësohet me formular përmbledhës vetëdeklarimi nuk gjejmë bazueshmëri që këto shoqëri të jenë skualifikuar për mangësi në plotësim dokumentacioni. Kjo për faktin se janë kompani që vazhdimisht marrin pjesë në prokurime publike të ngjashme dhe me vlera shumë herë më të mëdha që kërkojnë kapacitete shumë herë më të mëdha. Pra kërkojmë nga KPP që të administrohet dhe gjykohet procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO lidhur me mënyrën e vlerësimit të ofertave dhe mënyrën e llogaritjes së vlerave nga ana matematikore se çfarë formule ka zbatuar KVO që ka përcaktuar ofertën tonë si ofertë anonialisht e ulët? Duke qënë se nuk gjejmë shkak dhe arsye skualifikimi për mangësi dokumentacioni nga të tre operatorët, atëherë kalojmë tek llogaritja konkrete matematikore e 3 ofertave tashmë të vlefshme. Për këtë i kërkojmë AK të rivlerësojë procedurën duke korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe argumentuara më sipër, duke i kualifikuar të tre operatorit ekonomik pjesëmarrës dhe duke shpallur fitues shoqërinë tonë AME 2020.”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vëren:

Ankesa e Operatorit Ekonomik “A.M.E 2020” SHPK lidhet me faktin se;

- Oferta e paraqitur nuk është anomalisht e ulët, me çfarë arsye janë skualifikuar shoqëritë e tjera dhe se nga ana e AK duhet të rivlerësohet procedura, duke shpallur fitues shoqërinë A.M.E 2020 shpk.

Autoriteti Kontraktor DPPGJ referuar Urdhrit nr.1827/8Prot. datë 16.09.2025 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave për procedurën me objekt prokurimi “Blerje plehra kimike, furnitura veterinare, farëra, fidanë e të tjera produkte agrokulturore .

KVO ka vlerësuar ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik si oferta me vlerë nën kufijtë e lartë monetar e cila është konstatuar anomalisht e ulët, referuar pikës 5 të Nenit 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

Operatori ekonomik AGROKORANI është skualifikuar nga KVO për dy arsye kryesore: 1. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3. ku përcaktohet: “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi... dhe 2. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.2 ku përcaktohet ”Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punëtore të nevojshëm për realizimin e kontratës/ave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, me një numër prej mesatarisht 13 (trembëdhjetë), punonjës të punësuar për perfudhën 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës...

Rrjedhimisht OE AGROKORANI është skualifikuar, oferta e tij nuk llogaritet si ofertë e vlefshme dhe nuk përfshihet në llogaritjen e mesatares për ofertat anomalisht të ulëta.

KVO ka përdorur formulën e ofertave të vlefshme sipas pikës 4 të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

Pika 4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime

nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Pra, përlllogaritja e ofertës anomalisht e ulët bëhet në mënyrën e mëposhtme :

1. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur,

Në këtë rast kemi dy oferta të vlefshme Agro-Korani dhe A.M.E 2020.

Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në procedurë:

- 1- A.M.E. 2020 shpk me vlerë të ofertuar 4.950.750,00 lekë*
- 2- AGRO-KORANI me vlerë të ofertuar 5.097.000,00 lekë - skualifikuar*
- 3- ALBGARDEN me vlerë të ofertuar 5.178.120,00 lekë*

Formula: Oferta anomalisht e ulët < 0.75 x fondi limit, pra 0.75 x 7.409.362 = 5,557,021.5 lekë.

Pra, çdo ofertë që është më e ulët se 5,557,021.5 lekë konsiderohet anomalisht e ulët.

Operatorët: A.M.E 2020 shpk me vlerë të ofertuar 4.950.750,00 lekë dhe ALBGARDEN me vlerë të ofertuar 5.178.120,00 lekë kanë vlerë më të ulët se kufiri 75% të Fondit Limit.

Pra 49507500 < 55570215 lekë dhe 517812000 < 55570215 lekë

Kjo do të thotë që ofertat janë anomalisht të ulëta.

Sa më sipër KSHA,

VENDOSI:

Refuzimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-61956-09-18-2025, me objekt: “Blerje plehra kimikë, furnitura veterinare, farëra, fidanë e të tjera produkte agrokulturore”, me fond limit 7.409.362 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar më datë 06.10.2025 nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.”.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga ana e operatorëve ekonomik të interesuar në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” ShPK, në këtë procedurë prokurimi, si në vijim: *“Oferta e shoqërisë AME 2020 është skualifikuar si ofertë anomalisht e ulët.*

Anomalisht e ulët mbi çfarë baze është bazuar KVO për ofertën anomalisht të ulët si arsye skualifikimi??? Me metodën e 25% zbritje oferte nga fondi limit apo me metodën e 85%-shit të mesatares ë ofertave të vlefshme???!! KVO qëllimisht është e paqartë në skualifikimin e ofertës tonë, duke thënë arsyen vetëm “Oferta Anomalishte ulët”.!”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

III.1.2. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 4, parashikohet shprehimisht se:

“Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuar < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”.

III.1.3. Referuar ankesës së paraqitur, informacionit të autoritetit kontraktor si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se, në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me numër reference Nr. REF-61956-09-18-2025, me objekt: “Blerje Plehra Kimik, Furnitura Veterinare, Farëra, Fidanë e të tjera produkte Agrokulturore”, me fond limit të përgjithshëm 7,409,362 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, kanë ofertuar 3 (tre) operatorë ekonomikë nga të cilët 2 (dy) prej tyre rezultojnë se përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme në respektim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Mbi bazën e këtij kualifikimi KVO-ja ka aplikuar formulën për ofertën/ofertat anomalisht të ulët/ulta mbështetur në përcaktimet ligjore të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe DST.

Në rastin në fjalë janë të vlefshme 2 (dy) oferta (*përfshirë këtu ofertën e shoqërisë “A.M.E 2020” SHPK, të refuzuar nga KVO-ja si ofertë anomalisht të ulët*) dhe në përputhje me nenin 93, të LPP-së, në rastin kur ka 2 (dy) ose më pak oferta të vlefshme (*të kualifikuara*) atëherë oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e ofertës është ulur më shumë se 25% e fondit limit të procedurës së prokurimit .

Nga përlllogaritjet e kryera nga KPP, konstatohet, se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK është në vlerën prej 4.950.750 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët, pasi vlera e saj është ulur më shumë se 25% e fondit limit të procedurës së prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 dhe 5 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar anomalisht e ulët nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Në rastin konkret, në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të LPP-së se: *në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët*”, procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi “*E hapur e thjeshtuar*”, me numër reference Nr. REF-61956-09-18-2025, me objekt: “*Blerje Plehra Kimik, Furnitura Veterinare, Farëra, Fidanë e të tjera produkte Agrokulturore*”, me fond limit të përgjithshëm 7,409,362 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, vlerë e cila rezulton nën kufirin e lartë monetar, referuar Kreut II “*KUFIJTË MONETAR NË SEKTORIN KLASIK*” të VKM-së nr.291, datë 15.05.2024 “*PËR PËRCAKTIMIN E KUFIJVE MONETARË NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK*” ku përcaktohet se:

“1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

- a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;
- b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

- a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.”.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” ShPK, nuk qëndron, pasi në këtë procedurë prokurimi, e cila referuar fondit limit të përgjithshëm të përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe përcaktimeve të Kreut II “KUFIJTË MONETAR NË SEKTORIN KLASIK” pika 1 të VKM-së nr.291, datë 15.05.2024 “PËR PËRCAKTIMIN E KUFIJVE MONETARË NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK” kjo procedurë prokurimi është nën kufirin e lartë monetar, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar shkresën nr. 1827/21 prot, datë 07.11.2025 “Vendim”, protokolluar me tonën me nr. 3100/2 prot, datë 10.11.2025 edhe verifikimeve të bëra në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), në datën 22.08.2025 janë kualifikuar ofertat e 2 (dy) operatorëve ekonomikë, ku referuar përcaktimeve të nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4, të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, oferta ekonomike e operatorit ekonomik ofertues të kualifikuar “A.M.E 2020” SHPK rezulton anomalisht e ulët dhe si rrjedhim është në kushtet e përcaktimeve të nenit 93 pika 5 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ndaj nuk mund të kualifikohet.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” ShPK nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” ShPK, si në vijim: “Po 2 shoqëritë e tjera me çfarë arsye skualifikimi janë skualifikuar????!!

Duke patur parasysh llojin e objektit të prokurimit që është “Blerje malli”, duke patur parasysh kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT, ku vërehet qartazi se përveç sigurimit të ofertës, xhiros, punëve të ngjashme, ISO-s, pjesa tjetër e kriterëve specifikisht teknike kërkohet të plotësohet me Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi, nuk gjejmë bazueshmëri që këto shoqëri të jenë skualifikuar për mangësi në plotësim dokumentacioni. Kjo për faktin edhe se, janë kompani që vazhdimisht marrin pjesë në prokurime publike të ngjashme dhe me vlera shumë herë më të mëdha që kërkojnë kapacitete shumë herë më të mëdha.

Pra, kërkojmë nga Komisioni i Prokurimit Publik që të administrohet dhe gjykohet Procesverbali i hapjes dhe Procesverbali i Vlerësimit të Ofertave nga KVO lidhur me mënyrën e vlerësimit të ofertave dhe mënyrën e llogaritjes së vlerave nga ana matematikore se çfarë formule ka zbatuar KVO që ka përcaktuar ofertën tonë si ofertë anomalisht të ulët.????!!

...

Për këtë arsye, duke njohur kapacitetet dhe potencialin dhe peshën e tyre në treg të kompanive pjesëmarrëse në tender nuk gjejmë arsye se përse të skualifikohen nga kjo procedurë prokurimi me kriter bazike.

Për këtë, i kërkojmë Autoritetit Kontraktor të rivlerësojë procedurën duke korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe argumentuara më sipër, duke i kualifikuar të tre operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe duke shpallur fitues shoqërinë tonë AME 2020.”, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se,

III.2.1. Në datën 19.09.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me numër reference Nr. REF-61956-09-18-2025, me objekt: “Blerje Plehra Kimik, Furnitura Veterinare, Farëra, Fidanë e të tjera produkte Agrokulturore”, me fond limit të përgjithshëm 7,409,362 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit.

III.2.2. Në datë 06.10.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) rezulton se në datën 22.10.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1	"A.M.E 2020" shpk	me vlerë oferte	4.950.750	leke	skualifikuar
2	"AGRO-KORANI" shpk	me vlerë oferte	5.097.000	leke	skualifikuar
3	"AlbGarden" shpk	me vlerë oferte	5.178.120	leke	skualifikuar

III.2.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 22.10.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me arsyet e skualifikimit, përkatësisht si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik ofertues "A.M.E 2020" shpk:

“Operatori ekonomik skualifikohet pasi oferta e paraqitur prej tij konstatohet si anomalisht e ulët. Ndaj në përputhje me nenin 93 pika 5 e Ligjit nr. 162/2020 ‘Për Prokurimin Publik’, të ndryshuar ku percaktohet “Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”.”.

Operatori ekonomik ofertues " AGRO-KORANI " shpk:

“1. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3. ku percaktohet “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi:

- Çertifikate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certifikate origjinë të leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative) ose Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Çertifikate zyrtare model 3 te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4 te aneksit 4 dhe certifikate origjinë të leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të

fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative) ...” duke qene se dokumentet “Çertifikatë zyrtare” nr. i serisë 010, lëshuar mr 18.08.2025 dhe “Çertifikate origjine” lëshuar mr 18.08.2025, të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave, te paraqitura nga operatori ekonomik nuk permbajne mallrat objekt prokurimi(Tulipan (bulbë), Ciklaminë (Cyclamen), Violë, Agapanthus, Nandina domestica)

2. Operatori ekonomik nuk permbush kriterin 2.3.2 ku percaktohet “Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per realizimin e kontratës/ava që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër , me nje numer prej mesatarisht 13 (trembedhete), punonjes te punesuar për periudhën 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, përfshirë dhe stafin e meposhtem.... 2 (dy) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për ”Punime në fidanishte” duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm: • Kontratë pune (e vlefshme).

- Librezë pune

- Diplomë/certifikate sipas ligjit Nr. 15/2017.

Operatori ekonomik te paraqese deklarate ne lidhje me stafin e kerkuar ne piken 2.3.2 qe disponon sipas formatit te meposhtem: Tabela 1 Emer Mbiemer i Punonjësit Nr Identifikimi (ID/Letërnyoftim) Profesionit Institucioni Publik/Privat Lëshues i Certifikatës/Diplomës Nr NIPT i Institucionit (nëse privat) operatori ekonomik ofertues me dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, konkretisht ka deklaruar numrin e punonjësve që disponon, si dhe profilet e parashikuara në pikën 2.3.2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, të dokumenteve të tenderit, gjithashtu ka dorëzuar edhe një deklaratë për stafin e angazhuar, pra listë të punonjësve me profesionet përkatëse me të dhënat edhe të kompanisë certifikuese e cila ka lëshuar dokumentat certifikata për punonjësit. Në dokumentin “TABELA_1_-_Deklarate_per_Safin_e_Angazhuar”, operatori ekonomik, ka deklaruar që stafi është i certifikuar nga subjekti privat me emrin tregtar “AQS CERT” Shpk me Nipt L31511026K, i cili nuk është i licensuar për ofrimin e kurseve të formimit profesional për (Punime fidanishte) dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, që të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. KVO pasi verifikoi në faqen zyrtare të qkb.gov.al në seksionin kërko në Rregjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në hapsirën Licencat, Lejet e lëshuara nga QKB, rezulton se subjekti AQS CERT me nipt L31511026K, nuk është i licensuar nga Ministria e Financave për të ushtruar aktivitetin për formim profesional dhe pajisjen e me certifikata trajnimi punonjës për profilet (Punime në fidanishte). Per sa me lart rezulton se punonjësit e deklaruar si të certifikuar nga subjekti “AQS CERT”, nuk janë të vlefshme dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasi subjekti “AQS CERT” nuk ofron kurse të formimit profesional ndaj oferta e operatori ekonomik nuk konsiderohet e vlefshme.”.

Operatori ekonomik ofertues "AlbGarden" shpk:

“Operatori ekonomik është skualifikuar pasi oferta e paraqitur prej tij rezulton anomalisht e ulët Ndaj në përputhje me nenin 93 pika 5 e Ligjit nr. 162/2020 ‘Për Prokurimin Publik’, të ndryshuar ku percaktohet “Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë,

autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”.

III.2.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 24.10.2025 autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.2.6. Në datën 31.10.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6028 datë 31.10.2025 dhe me numër protokoli nr. 3100/2025 prot, datë 31.10.2025 e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ofertues “AGRO-KORANI” SHPK, si dhe mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ofertues “AlbGarden” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.2.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3100/1, datë 03.11.2025 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ofertues “AGRO-KORANI” SHPK, si dhe mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ofertues “AlbGarden” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.2.8. Në datë 10.11.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 1827/21 prot, datë 07.11.2025 “Vendim”, protokolluar me tonën me nr. 3100/2 prot, datë 10.11.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur mos pranimin e saj, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik se “oferta e AME 2020 është skualifikuar si ofertë anomalisht e ulët. Anomalisht e ulët mbi çfarë baze është bazuar KVO për ofertën anomalisht të ulët si arsye skualifikimi? Me metodën e 25% zbrilje nga fondi limit apo me metodën e 85% të mesatares së ofertave të vlefshme? KVO qëllimisht është e qartë në skualifikimin e ofertës tanë duke thënë arsyen e vetme “ofertë anomalisht e ulët”. Po dy shoqëritë e tjera me çfarë arsye skualifikimi janë skualifikuar? Duke patur parasysh llojin e objektit të prokurimit Që është “blerje malli”, duke patur parasysh kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST ku vërehet qartazi se përvec sigurimit të ofertës, xhiros, punëve të ngjashme, ISO, pjesa tjetër e kriterëve specifikisht teknike kërkohet të plotësohet me formular përmbledhës vetëdeklarimi nuk gjejmë bazueshmëri që këto shoqëri të jenë skualifikuar për

mangësi në plotësim dokumentacioni. Kjo për faktin se janë kompani që vazhdimisht marrin pjesë në prokurime publike të ngjashme dhe me vlera shumë herë më të mëdha që kërkojnë kapacitete shumë herë më të mëdha. Pra kërkojmë nga KPP që të administrohet dhe gjykohet procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO lidhur me mënyrën e vlerësimit të ofertave dhe mënyrën e llogaritjes së vlerave nga ana matematikore se çfarë formule ka zbatuar KVO që ka përcaktuar ofertën tonë si ofertë anonialisht e ulët? Duke qënë se nuk gjejmë shkak dhe arsye skualifikimi për mangësi dokumentacioni nga të tre operatorët, atëherë kalojmë tek llogaritja konkrete matematikore e 3 ofertave tashmë të vlefshme. Për këtë i kërkojmë AK të rivlerësojë procedurën duke korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe argumentuara më sipër, duke i kualifikuar të tre operatorit ekonomik pjesëmarrës dhe duke shpallur fitues shoqërinë tonë AME 2020.”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vëren:

Ankesa e Operatorit Ekonomik “A.M.E 2020” SHPK lidhet me faktin se;

- Oferta e paraqitur nuk është anomalisht e ulët, me çfarë arsye janë skualifikuar shoqëritë e tjera dhe se nga ana e AK duhet të rivlerësohet procedura, duke shpallur fitues shoqërinë A.M.E 2020 shpk.

Autoriteti Kontraktor DPPGJ referuar Urdhrit nr.1827/8Prot. datë 16.09.2025 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave për procedurën me objekt prokurimi “Blerje plehra kimike, furnitura veterinare, farëra, fidanë e të tjera produkte agrokulturore .

KVO ka vlerësuar ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik si oferta me vlerë nën kufijtë e lartë monetar e cila është konstatuar anomalisht e ulët, referuar pikës 5 të Nenit 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm

pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

Operatori ekonomik AGROKORANI është skualifikuar nga KVO për dy arsye kryesore: 1. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3. ku përcaktohet: “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi... dhe 2. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.2 ku përcaktohet ”Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punëtoare të nevojshëm për realizimin e kontratës/ave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, me një numër prej mesatarisht 13 (trembëdhjetë), punonjës të punësuar për perfudhën 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës...

Rrjedhimisht OE AGROKORANI është skualifikuar, oferta e tij nuk llogaritet si ofertë e vlefshme dhe nuk përfshihet në llogaritjen e mesatares për ofertat anomalisht të ulëta.

KVO ka përdorur formulën e ofertave të vlefshme sipas pikës 4 të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

Pika 4. *Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Pra, përllogaritja e ofertës anomalisht e ulët bëhet në mënyrën e mëposhtme :

1. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur,

Në këtë rast kemi dy oferta të vlefshme Agro-Korani dhe A.M.E 2020.

Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në procedurë:

- 1- A.M.E. 2020 shpk me vlerë të ofertuar 4.950.750,00 lekë
- 2- AGRO-KORANI me vlerë të ofertuar 5.097.000,00 lekë - skualifikuar
- 3- ALBGARDEN me vlerë të ofertuar 5.178.120,00 lekë

Formula: Oferta anomalisht e ulët $< 0.75 \times \text{fondi limit}$, pra $0.75 \times 7.409.362 = 5,557,021.5$ lekë.

Pra, çdo ofertë që është më e ulët se 5,557,021.5 lekë konsiderohet anomalisht e ulët.

Operatorët: A.M.E 2020 shpk me vlerë të ofertuar 4.950.750,00 lekë dhe ALBGARDEN me vlerë të ofertuar 5.178.120,00 lekë kanë vlerë më të ulët se kufiri 75% të Fondit Limit.

Pra $49507500 < 55570215$ lekë dhe $517812000 < 55570215$ lekë

Kjo do të thotë që ofertat janë anomalisht të ulëta.

Sa më sipër KSHA,

VENDOSI:

Refuzimin e plotë të ankesës së operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-61956-09-18-2025, me objekt: “Blerje plehra kimikë, furnitura veterinare, farëra, fidanë e të tjera produkte agrokulturore”, me fond limit 7.409.362 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar më datë 06.10.2025 nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.”.

III.2.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga ana e operatorëve ekonomik të interesuar në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III.2.10. Në nenin 109, pikat 1 “E drejta e ankimit” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit ose entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.2.11. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.2.12. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.2.13. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP-së, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik.”.

III.2.14. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (*argumentojë*), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet

të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

Neni 109, pika 1 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe neni 94, pika 1, i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar kërkojnë shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (*legjitimimi locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t’u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.2.15. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK përsa i përket kërkesës së tij për rivlerësimin e ofertës së shoqërisë “AGRO-KORANT” SHPK dhe kualifikimin e tij, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i kësaj shoqërie është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 22.10.2025, ku kjo shoqëri rezulton e skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi për mospërmbushje të kriterëve kualifikuese si në vijim: “1. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3. ku përcaktohet “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi:

- Çertifikate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certifikate origjinë të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative) ose Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Çertifikate zyrtare model 3 te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4 te aneksit 4 dhe certifikate origjine të leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative) ...”duke qene se dokumentet “Çertifikatë zyrtare” nr. i serisë 010, leshuar më 18.08.2025 dhe “Çertifikate origjine” leshuar më 18.08.2025, të leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave, të paraqitura nga operatori ekonomik nuk përmbajnë mallrat objekt prokurimi(Tulipan (bulbë), Ciklaminë (Cyclamen), Violë, Agapanthus, Nandina domestica)

2. Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.2 ku përcaktohet “Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për realizimin e kontratës/ava që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër , me një numër prej mesatarisht 13 (trembëdhjetë), punonjës të punësuar për periudhën 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, përfshirë dhe stafin e mëposhtem.... 2 (dy) punonjës të trajnuar me kurse të

trajnimin profesional për "Punime në fidanishte" duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- *Kontratë pune (e vlefshme).*

- *Librezë pune*

- *Diplomë/certifikatë sipas ligjit Nr. 15/2017.*

Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin e kerkuar në pikën 2.3.2 që disponon sipas formatit të mëposhtëm: Tabela 1 Emer Mbiemer i Punonjësit Nr Identifikimi (ID/Letërnjoftim) Profesionit Institucioni Publik/Privat Lëshues i Certifikatës/Diplomës Nr NIPT i Institucionit (nëse privat) operatori ekonomik ofertues me dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, konkretisht ka deklaruar numrin e punonjësve që disponon, si dhe profilet e parashikuara në pikën 2.3.2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, të dokumenteve të tenderit, gjithashtu ka dorëzuar edhe një deklaratë për stafin e angazhuar, pra listë të punonjësve me profesionet përkatëse me të dhënat edhe të kompanisë certifikuese e cila ka lëshuar dokumentat certifikata për punonjësit. Në dokumentin "TABELA_1 - _Deklaratë_per_Safin_e_Angazhuar", operatori ekonomik, ka deklaruar që stafi është i certifikuar nga subjekti privat me emrin tregtar "AQS CERT" Shpk me Nipt L31511026K, i cili nuk është i licensuar për ofrimin e kurseve të formimit profesional për (Punime fidanishte) dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, që të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.". KVO pasi verifikoi në faqen zyrtare të qkb.gov.al në seksionin kërko në Rregjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në hapsirën Licencat, Lejet e lëshuara nga QKB, rezultoi se subjekti AQS CERT me nipt L31511026K, nuk është i licencuar nga Ministria e Financave për të ushtruar aktivitetin për formim profesional dhe pajisjen e me certifikata trajnimi punonjës për profilet (Punime në fidanishte). Për sa më lart rezultoi se punonjësit e deklaruar si të certifikuar nga subjekti "AQS CERT", nuk janë të vlefshme dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasi subjekti "AQS CERT" nuk ofron kurse të formimit profesional ndaj oferta e operatori ekonomik nuk konsiderohet e vlefshme." dhe për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezultoi që operatori ekonomik "AGRO-KORANT" SHPK të ketë ankimuar këto arsye skualifikimi në këtë procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit, pasi mbetja e skualifikuar e këtij operatori ekonomik nuk sjell rivlerësimin dhe rrjedhimisht ndryshimin e statusit të ofertave të operatorit ekonomik ankimues "A.M.E 2020" SHPK dhe të operatorit ekonomik ofertues "AlbGarden" SHPK, të cilat përmbushin kriteret kualifikuese të dokumentave të tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik "A.M.E 2020" SHPK nuk do të merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në

një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” ShPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me numër reference Nr. REF-61956-09-18-2025, me objekt: “Blerje Plehra Kimik, Furnitura Veterinare, Farëra, Fidanë e të tjera produkte Agrokulturore”, e ndarë në lote”, me fond limit të përgjithshëm 7,409,362 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 06.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohej të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” ShPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

